



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, duke vendosur sipas kërkesës 05Nr. 391/02-263087/21 dt.03.12.2021, të pronareve Nexhat Abazi dhe Xhevat Abazi nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për dy ndërtesa shtëpi individuale të banimit, ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” në rr. “Shyqeri Kushevisa”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 21.03.2022, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** Nexhat Abazi dhe Xhevat Abazi nga Prishtinë, sipas kërkesës 05nr.391/02-263087/21 dt.03.12.2021, përdorimi i ndërtesave / shtëpive individuale të banimit, përkatësisht “Objekti nr.1” dhe “Objekti nr.2” me etazhitet B+P+2, të ndërtuara me Vendimin e Lejes Ndërtimore 05nr.351/02-37949/19 dt.13.03.2019, në parcelat kadastrale nr.838-3 dhe 838-2 ZK Sofali, me pronarë Ismajl Abazi, konkretisht në kuadër Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” në Prishtinë.
- II. Ndërtesat** nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Shyqeri Kushevisa” ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numër: 39 dhe 37 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor për banim, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III. Certifikata** do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.
- VI. Pjesë përbërëse** e këtij akti administrativë - certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkesit / pronarët Nexhat Abazi dhe Xhevat Abazi nga Prishtinë, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-263087/21 dt.03.12.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat / shtëpit individuale të banimit, përkatësisht “Objekti nr.1” dhe “Objekti nr.2” me etazhitet B+P+2, të ndërtuara në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.838-3 me pronarë Nexhat Abazi dhe 838-2 me pronarë Xhevat Abazi, ZK Sofali, të ndërtuara me Vendimin e Lejes Ndërtimore 05nr.351/02-37949/19 dt.13.03.2019, në emër të Ismajl Abazi, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Drejtorja e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09nr.391/02-239172/20 dt. 03.12.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista

kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3. Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4. Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Përparim Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Vullnet Neziri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Muhedin Morina; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Asmir Hamdi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodeite e licensuar "Geoworld" shpk me nr. të licensës 12;

Kjo drejtori, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës bazuar në kërkesën për leje ndërtimore 05nr.351/02 – 37949/19 dt.19.02.2019 me Vednim 05nr.351/02 – 37949/19 dt.13.03.2019 ka lejuar kërkesit Ismajl Abazi nga Prishtina ndërtimin e ndërtesave individuale banimor / shtëpive familjara përkatësisht "Objekti nr.1" dhe "Objekti nr.2" me etazhitet B+P+2, e ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 838-3 dhe 838-3 ZK Sofali. Në ndërkohë pronari i lejes ndërtimore dhe parcelave kadastrale të lartë cekura ka ndrruar jetë, ku dëshmohet edhe me aktin noterial Aktvendim përpiluar te Noter Safedin Blaka, M.A. në Prishtinë me LRP.nr.8591/2021 dhe REF.T.nr.2245/2021 dt.07.06.2021, konkretisht akti noterial i trashigimis. Në këtë rast si trashigimtar i parcelave kadastrale dhe shtëpive të ndërtuara në kuadër të tyre janë Nexhat Abazi pronar i parcelës 838-3 ZK Sofali dhe Xhevat Abazi pronar i parcelës 838-2 ZK Sofali. Gjith ashtu si dëshmi është edhe certifikata e pronës e parcelave kadastrale nr.838-2 me pronar Xhevat Abazi dhe nr. 838-3 ZK Sofali me pronar Nexhat Abazi;

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shtëpi individuale e banimit mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shtëpi individuale e banimit mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shtëpi individuale të banimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës 05nr.391/02-263087/21 dt.03.12.2021.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05NR.391/02 - 263087/21 DT.21.03.2022**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha Prestreshi



Faqe 2 prej 3